



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONI I ANKIMIMEVE DHE
I SANKSIONEVE

Data: 22 Prill 2021

Nr: 33

VENDIM

PËR PRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS ANKIMORE NR. 18, PARAQITUR NË
KQZ NË DATËN 22.04.2021

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 22.04.2021, me pjesëmarrjen e:

Elvis ÇEFA	-	Relator
Elvin LAKO	-	Anëtar
Ilijan RUSMALI	-	Anëtar
Koli BELE	-	Anëtar
Ledio BRAHO	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

KËRKUES: Partia Lëvizja për Ndryshim

OBJEKT: Shqyrtimi i kërkesës ankimore nr. 18, të partisë Lëvizja për Ndryshim me objekt 1. Kundërshtimin e vendimit nr. 11, datë 20.04.2021 të Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor (KZAZ) nr. 52, qarku Elbasan. 2. Detyrimin e KZAZ nr. 52 për akreditimin e vëzhguesve të Partisë Lëvizja për Ndryshim për vëzhgimin e procesit zgjedhor për Kuvend të datës 25 prill 2021, sipas listës dërguar KZAZ-së.

BAZË LIGJORE: Nenet 21, 123/1, 124, 126, 129, 130 dhe 131 të “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenet 17 dhe 18 të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”.

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur si dhe dëgjoji diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,



VËREN:

Subjekti ankues partia Lëvizja për Ndryshim ka depozituar pranë KQZ-së kërkesë ankimore, e cila në respektim të kritereve të përcaktuara në nenin 127 të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 18 regj., datë 22.04.2021.

Në mbledhjen e datës 22.04.2021, ora 19:00, pas relativitetit të z. Elvis Çefa u konstatua se kërkesa ankimore nr. 18 i plotëson elementët e formës të parashikuara në nenin 126, dhe elementet e përcaktuara në nenin 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe në mbështetje të nenit 17 pika 3, shkronja “a” të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”, Kërkesa Ankimore duhet të kalohet për shqyrtim.

PËR KËTO ARSYE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve mbështetur në nenet 21, pika 1, shkronja “b” 126 dhe 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të nenit 17 pika 3, shkronjat “a” e 18 të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”,

V E N D O S I:

1. Pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 18, datë 22.04.2021, të paraqitur nga Partia Lëvizja për Ndryshim.
2. Shqyrtimi do të bëhet në datën 23 Prill 2021, në orën 12:00.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Elvis **ÇEFA** - **Relator**

Elvin **LAKO** - **Anëtar**

Ilirjan **RUSMALI** - **Anëtar**

Koli **BELE** - **Anëtar**

Ledio **BRAHO** - **Anëtar**

